



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe
Monitorimit

Data	
Nr.	Prot.

RELACION
PROJEKTUDHËZIM
PËR

MIRATIMIN E MODELIT TË AKTMARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

NDËRMJET KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE DHE PARTISË POLITIKE QË
PËRFITON FONDET NGA BUXHETI I SHTETIT DHE KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI

Neni 19, pikat 1, shkronjat “d”, “dh”, “ë”, “k”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të lidhur marrëveshje dhe kontrata me të tretët, monitoruar ose kontrolluar zbatimin e tyre, si dhe për të administruar buxhetin e KQZ-së, sipas rregullave të fushatës.

Neni 88, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton fondet nga buxheti i shtetit për financimin e partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje, pranimin e fondit nga partitë politike dhe ta përdorin atë fond në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në ligj, pranimin e monitorimit të shpenzimeve të fondeve të dhëna, si dhe respektimin e ndalimeve dhe kufizimeve të përcaktuara në ligj.

Në bazë dhe për zbatim të dispozitave të sipërcituara është hartuar projektakti “Për miratimin e modelit të aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Partisë Politike që përfiton fondet nga buxheti i shtetit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTUDHEZIMIT

Qëllimi i kësaj aktmarrëveshjeje është angazhimi i palëve për përdorimin e fondeve të përfituara nga Buxheti i Shtetit dhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe që i jepen partisë politike përfituese, në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 28.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Partia Politike që përfiton fonde nga Buxheti i Shtetit dhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr përsipër:

- Të pranojë fondin e dhënë dhe ta përdor atë në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 28.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Të pranojë monitorimin e shpenzimeve të fondeve të dhëna për të si subjekt zgjedhor dhe kandidatëve të tij.
- Të respektojë të gjitha ndalimet dhe kufizimet që përcaktohen në ligjin nr. 10019, datë 28.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Në rast se partia politike nuk zbaton përcaktimin e bërë në nenin 88, paragrafi 7, të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, atëherë përjashtohet nga e drejta për të përfituar fonde publike për një periudhë jo më pak se 5 vjet, përveçse kur shlyen detyrimin bashkë me gjobën.

Bazuar në nenet 92/4 dhe 92/6, partia politike pranon monitorimin e aktivitetit të saj gjatë fushatës zgjedhore dhe 4 muaj para datës së zgjedhjeve pavarësisht faktit nëse regjistrohet më vete si subjekt zgjedhor apo në kuadër të një koalicioni zgjedhor, si dhe auditimin e fondeve dhe të shpenzimeve të fushatës zgjedhore.

Palët me vullnet të lirë marrin përsipër të respektojnë dhe të përmbushin detyrimet sipas kësaj aktmarrëveshjeje.

Risi në këtë projektudhëzim:

- Ndryshimi i formatit të aktmarrëveshjes
- Heqja e vitit 2021

Për sa më lartë, në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim

dhe miratim e projektudhëzimit “Për miratimin e modelit të aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Partisë Politike që përfiton fondet nga buxheti i shtetit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”.

Valbona BALLGJINI - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit

Majlinda ÇELMETA -Drejtor i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTUDHËZIM

PËR

MIRATIMIN E MODELIT TË AKTMARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

NDËRMJET KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE DHE PARTISË POLITIKE QË
PËRFITON FONDET NGA BUXHETI I SHTETIT DHE KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “d”, “dh”, “ë”, “k”, e 2, dhe nenit 88, të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Miratimin e modelit të aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Partisë Politike që përfiton fonde nga Buxheti i Shtetit dhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas modelit KQZ xx-xx, shtojca nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.
2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohen në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



Për miratimin e modelit të aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe partisë politike që përfiton fondet nga Buxheti i Shtetit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

AKTMARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot më datë __.__.202_, nënshkruhet kjo aktmarrëveshje bashkëpunimi midis palëve:

I) KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

1. [Redacted]
(Emër, Atësia, Mbiemër)

2. Adresa [Redacted]

3. Tel/Cel [Redacted] 4. Email [Redacted]

I) TË DHËNAT E PARTISË POLITIKE

1. Partia Politike [Redacted] . Shkronjat nistore [Redacted]

3. Kryetari [Redacted] 4. Selia [Redacted]
(Emër,

5. NIPT [Redacted] 6. Përfaqësuar [Redacted]
nga
(Emër, Mbiemër)

Palët bien dakord të lidhin këtë aktmarrëveshje bashkëpunimi (këtu e më poshtë referuar si “aktmarrëveshje”) me kushtet si më poshtë vijon:



Neni 1

Qëllimi i aktmarrëveshjes

Qëllimi i kësaj aktmarrëveshjeje është angazhimi i palëve për përdorimin e fondeve të përfituara nga Buxheti i Shtetit dhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe që i jepen partisë politike përfituese, në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo aktmarrëveshje hartohet në bazë të nenit 88 të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 3

Detyrimet e Partisë Politike

Partia Politike që përfiton fonde nga Buxheti i Shtetit dhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr përsipër:

1. Të pranojë fondin e dhënë dhe ta përdor atë në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Të pranojë monitorimin e shpenzimeve të fondeve të dhëna për të si subjekt zgjedhor dhe kandidatëve të tij.
3. Të respektojë të gjitha ndalimet dhe kufizimet që përcaktohen në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
4. Në rast se partia politike nuk zbaton përcaktimin e bërë në nenin 88, paragrafi 7, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, atëherë përjashtohet nga e drejta për të përfituar fonde publike për një periudhë jo më pak se 5 vjet, përveçse kur shlyen detyrimin bashkë me gjobën.



Neni 4

Detyrimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve merr përsipër:

1. Të përcaktojë dhe të shpërndajë fondin e përcaktuar për secilën parti politike jo më vonë se 5 ditë nga regjistrimi i listave shumëmemërore ose kandidatëve për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore të partisë përkatëse.
2. Të monitorojë nëpërmjet administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve apo subjekteve të kontraktuara prej tij respektimin e detyrimeve ligjore të subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve të tyre për shpenzimet e tyre në fushatën zgjedhore.

Neni 5

Pikat e kontaktit

Për zbatimin e kësaj aktmarrëveshjeje palët përcaktojnë këto pika kontakti:

I) KOMISIONI
QENDROR I
ZGJEDHJEVE

1. Z. /Zj.

(Emër, Mbiemër)

2. Email

3. Tel/Cel

4. Adresa

I) PARTIA POLITIKE

1. Z./Zj.

(Emër, Mbiemër)

2. Email

3. Tel/Cel

4. Adresa



Neni 6

Auditimi dhe monitorimi

Partia politike pranon auditimin e fondeve dhe të shpenzimeve të fushatës zgjedhore sipas nenit 92/6 të Kodit Zgjedhor, si dhe monitorimin e aktivitetit të saj gjatë fushatës zgjedhore dhe 4 muaj para datës së zgjedhjeve sipas nenit 92/4 të Kodit Zgjedhor, pavarësisht faktit nëse regjistrohet më vete si subjekt zgjedhor apo në kuadër të një koalicioni zgjedhor.

Neni 7

Angazhim i përbashkët

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Partia Politike _____ angazhohen të shqyrtojnë në mënyrë të ndërsjelltë kërkesat dhe propozimet e dyanshme dhe të mbajnë kontakte të rregullta nëpërmjet strukturave përgjegjëse.

Neni 8

Dispozita të fundit

Palët me vullnet të lirë marrin përsipër të respektojnë dhe të përmbushin detyrimet sipas kësaj aktmarrëveshjeje.

Kjo aktmarrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

Tiranë më __.__. 202__

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Partia Politike

Kryetari/Përfaqësuesi _____